

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN – Departamenti i pergjithshem Penal, gjyqtari i vetem gjykues Fatmir Krasniqi me sekretaren juridike Fatime Bajraktari, në lëndën penale kundër të akuzuares B.M nga ..., per shkak te vepres penale vjedhje e sherbimeve komunale nga neni 320 te KP-es, sipas aktakuzes së Prokurorise Themelore në Prizren PP.nr.500-3/2016 të datës 21.03.2016, pas mbajtjes së seancës fillestare publike, në prezencën e Prokurorit Themelore në Prizren Fatos Ajvazi, të akuzuares me datë **27.12.2016**, morri dhe shpalli publikisht këtë:

AKTGJYKIM

E akuzuara **B.M**, nga i ati H., e ëma N., e vajzëris ..., e lindur më datë ... në ..., tani me banim ne ... ne rr.... nr. ..., e martuar nene e 4 femijeve, amvise, shkollen fillore te kryer, e gjendjes se dobet ekonomike, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTORE

Prej dates se pavertetuar e deri me dt.30.11.2015, ne Prizren, pikerisht ne shtepin e saj familjare – si shfrytezuere, perfiton nga sherbimi komunal permes rrjetit perçues te rrymes apo rrjetit te shperndarjes pa autorizim te shfrytezuesit te autorizuar, ne ate menyre qe ka shfrytezuar energjin elektrike me njehsor i cili bllobat shteterore i ka te falsifikuara, ne mbrendi numruesi eshte i manipuluar, ka gjurme te gervishjes se numrave ne numrator, ashtu qe energjia elektrike e shpenzuar nuk regjistrohet, me ç’rast ndermarrjes se demtuar keds departamenti ligjor ne Prizren, i shkakton dem material,

-kesodore ka kryer vepren penale vjedhje e sherbimeve komunale nga neni 320 te KP-es,

Gjykata në bazë të nenit 7, 41, 42, 43, 46, 49 par.1 p.1.1, 50, 51, 52, 73, 74, 75 e 76 te KPK-se, dhe neni 365 te KPPK-es te akuzuares i shqipton:

DENIM ME KUSHT

Ashtu qe i verteton:

-Denimin me gjobe ne shumen prej **150 euro**, i cili denim nuk do te ekzekutohet nese e akuzuara ne afatin kohor prej 1 viti, nga dita e plotefuqishmeris se ketij aktgjykimi nuk do te kryen veper te re penale.

Ashtu qe i verteton denimin me burgim ne kohezgjatje prej **3 muajve** i cili denim nuk do te ekzekutohet ne afatin prej **1 viti** nga dita e plotefuqishmeris se ketij aktvendimi, nese e akuzuara nuk do te kryen ndonje veper te re penale

E akuzuara ne kuptim te nenit 454 te KPPK lirohet nga shpenzimet e procedures penale si dhe ato te paushallit gjyqesor.

Perfaqesuesi i te demtuares Keds – distrikti ne Prizren, per realizimin e kerkeses pasuroro juridike, udhezohet ne kontest te rregullt civilo juridik.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Prizren, kesaj gjykate i ka parashtruar aktakuzen me PP.nr.500-3/2016 te dt.21.03.2016, kunder te akuzuares B.M nga ..., per shkak te vepres penale vjedhje e sherbimeve komunale nga neni 320 te KP-es.

Prokurori Themelor ne Prizren Fatos Ajvazi ne fjalen e tije perfundimtare ka deklaruar, se qendron ne teresi prane aktakuzes, me arsyetim se nga deklarata e te akuzuares se e njejta e pranon fajesine ne menyre vullnetare, si dhe te gjitha provat e bashkangjitura kesaj aktakuze eshte vertetuar ne teresi gjendja faktike e pershkruar si ne dispozitiv te aktakuzes, prandaj propozon gjykates qe e akuzuara te shpallet fajtore dhe te denohet sipas ligjit.

E akuzuara B.M ne fjalen e saje perfundimtare deklarone, se e ndien vehten fajtore per vepren penale e cila i vihet ne barre nga ana e PTH-es ne Prizren, te njejten vullnetarisht e pranon fajesin, gjykates i propozon qe me rastin e caktimit te denimit, te ket parasysh sinqeritetin dhe karakterin me te larte njerezor pendimin per kete veper penale, ne te ardhmen do te jete me e kujdesshme dhe nuk do te perseris veper penale te kesaj natyre e as veper te ndonje lloji tjeter i cili bie ne kundertshtim me kodin penal te Kosoves, amvise, e gjendjes se dobet ekonomike, mbajtese e familjes 6 anetaresh.

Gjykata ne shqyrtim kryesore ka vertetuar gjendjen e ketille faktike nga pranimi i fajesise nga ana e te akuzuares e cila vullnetarisht e ka pranuar fajesin, per shkak te se ciles gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyres zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonje prove e pa pranueshme, gjithashtu gjykata ne teresi ka vertetuar se e akuzuara ka kuptuar natyren dhe pasojat e pranimi te fajit per vepren penale e cila i vihet ne bare, e qe pranimi i fajit eshte bere ne menyre vullnetare dhe pa kushtezime, duke u mbeshtetur ne fakte dhe prova materiale te cilat jane paraqitur ne aktakuze, per te cilat e akuzuara ka qene e njoftuar me te gjitha provat materiale. Gjykat ka ardhur ne perfundim, se pranimi i fajesise nga ana e te akuzuares eshte bere ne pajtim me nenin 248 te KPPK-se, dhe faktet qe permban aktakuza, ne veprimet e te akuzuares formohen te gjitha elementet e vepres penale vjedhje e sherbimeve komunale nga neni 320 te KP-se, dhe per kete gjykata te akuzuaren e shpalli fajtore dhe i shqiptoi denimin me kusht si te merituar, paraprakisht duke e vertetuar pergjegjesine e saje penalo-juridike.

Me rastin e caktimit te denimit ndaj te akuzuarit gjykata vleresoi te gjitha rrethanat ne kuptim te nenit 73 te KP-se te cilat ndikojne ne llojin dhe lartesine e denimit, duke mos e gjetur rrethanat posaqerisht renduese, e si rrethane lehtesuese eshte marre pranimi i fajesise nga ana e te akuzuares, sjellja korrekte pas kryerjes se vepres penale, pendimi i thelle i saje, ne kuptim te nenit 74, 75, e 76 gjykata morri per baze edhe faktin se e akuzuara ka bashkepunuar me gjykatën, bashkepunimi i saje ka qene vullnetar ne hetimin dhe ndjekjen penale, gjer me tani e pa gjykuar, çka nenkupton se nuk ka ardhur ndesh me

rregullat pozitive, amvise, e gjendjes se dobet ekonomike, mbajtese e familjes 6 anetareshe, andaj gjykata iu shqiptoi denimin kumulativ me kusht sepse konsideron se me kete mase sanksionuese do te arrihet qellimi i denimit, duke menduar se denimi i shqiptuar i pergjigjet shkalles se pergjegjesise se saje dhe me kete denim do te arrihet qellimi i denimit qe ne te ardhmen te jete e kujdesshme dhe do te permbahet nga veprimet e tilla.

Vendimi mbi paushallin gjyqesor gjykata e bazoi ne kuptim te nenit 454 te KPPK-se.

Si u cek edhe më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr. 611/16 të datës 27.12.2016

Sekretare Juridike
Fatime Bajraktari

Gjyqtari
Fatmir Krasniqi

UDHËZIM JURIDIK: Kunder ketij aktgjykimi pala e pakenaqr ka te drejte ankese ne afat prej 15 diteve nga dita e marrjes se te njejtës, Gjykates se Apelit ne Prishtine nepermjet te kesaj gjykate.